REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 897/20
Datë/Datum. 19.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ekspert Shqyrtues , Agim SHEQIRI Nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit 9.11.2020	Data e dorëzimit të raportit 19.11.2020	Nr. i lëndës:Nr 897/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.11 .2020 OE." "Graniti" SH.P.K, ka parashtruar ankesë me nr: **897/20**, kundër vendimit të datës 20.10.2020 për anulim të tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit: ": **Furnizim me inventar për zyre" me nr te prok: 214-20-4100-1-1-1**, iniciuar nga AK– **"Policia e Kosovës" për Lot I**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë për të hapur , vlera e parashikuar e kontratës: 160.000.00 € dhe tenderi ka qen i ndarë në dy llote (pjesë)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 44.5 i RRUOPP-
së.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt. 20.10.2020. ku është anuluar aktiviteti e prokurimit duke u bazuar në nenin 62 pika 1.1 të LPP-së një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit. e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve lë prokurimit. duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji

kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.20.10.2020. ku është anuluar aktivitetin e prokurimit duke u bazuar në nenin 62 pika 1.1 të LPP-së një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit. e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve lë prokurimit. duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit

Në lidhje me arsyetimin e AK-së ku e ka cekur se në specifikimet teknike janë bërë gabime teknike dhe rekomandohet që ky projekt të anulohet si më poshtë:

Sa i përket arsyetimit të AK-së ku e ka cekur se për pozicionin nr.4-Dollap exsluzivë dimensioni (H=200mmxË=800mm x L=450 m)- thellësia e dollapit është specifikuar me metra e jo me milimetra. andaj kjo ka shkaktuar konfuzion edhe te Operatorët Ekonomik ku disa kanë ofruar për këtë dimension me metra e disa me milimetra

Ky arsyetim i AK-së në lidhje me dimensionin e lartcekur është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne kemi ofertuar në dimensionin standard të thellësisë së dollapit edhe përkundër gabimit të AK-së. andaj duke marrë parasysh se ne kemi ofertuar ashtu siq duhet. autoriteti kontraktues është dashur ta merr parasysh ofertën tonë konform standardeve të aplikueshme andaj arsyeja e AK-së se ka gabime në pozicionin e lartcekur dhe është shkaktuar konfuzion tek OE nuk qëndron dhe është e pa bazuar pasi që OE të cilët kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. janë të gjithë profesionistë dhe e kuptojnë gabimin e AK-së andaj edhe është dashur të ofertojnë më dimensionet standard për këtë pozicion. Pra përderisa të gjithë OE të cilët kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit janë OE me përvojë është e qartë se të gjithë janë në dijeni se thellësia e dollapit nuk mund të jetë 450 metra. andaj arsyetimi se është krijuar konfuzion nuk qëndron dhe oferta jonë është dashur të konsiderohet e përgjegjshme

Arsyeja tjetër e AK-së në lidhje me pozicionin Nr.9 Vitrinë me dy dyer për zyre (Ë=800mmxL=410mm x L=2070mm) ku e ka cekur se është kërkuar dimensioni i të jetë 2100x2660mm dhe peshë 110-120/kg- andaj pesha e vitrinës nuk është dashtë të vendoset ose nuk është bërë një parallogaritje e duhur duke pas parasysh se pesha është shumë e madhe (rëndë). Ky arsyetim i AK-së nuk qëndron dhe është i pa bazuar pasi që edhe për këtë pozicion pavarësisht gabimit të AK-së ne kemi ofertuar ashtu siç janë dimensionet standarde sa i përket pozicionit të lartcekur. andaj arsyetimi i AK-së se pasha e kërkuar është shumë e rëndë nuk ka rëndësi pasi që ne kemi ofertuar ashtu siç është dashur të jetë përcaktimi dhe parashikimi i peshës. Pra duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë se oferta jonë është e përgjegjshme edhe përkundër faktit se AK-ja ka bërë gabime në kërkesën e lartcekur

Në lidhje me arsyet e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit sa i përket pozicioneve të mëposhtme:
Nr.10 Tavolinë ekskluzive për takime-mbledhje për Katër (4) karrige - (mungojnë

Dimensionet).
Nr.l1 Tavolinë ekskluzive për takime-mbledhje për Gjashtë (6) karrige - (mungojnë Dimensionet).
Nr.l2 Tavolinë ekskluzive për takime-mbledhje për Dymbëdhjetë (12) karrige - (mungojnë Dimensionet), andaj sa i përket arsyeve së AK-së ku e ka cekur se mungojnë dimensionet në lidhje me pozicionet e lartcekura. ju sqarojmë se këto arsye nuk qëndrojnë sepse dimensionet standarde në lidhje me këto tavolina i kanë të qarta të gjithë OE ofertues duke u bazuar në standarde profesionale dhe teknike andaj edhe ne kemi ofertuar sipas dimensioneve standarde për tavolinat e lartcekura dhe nuk është dashur të anulohet aktiviteti i prokurimit për faktin se oferta jonë është e përgjegjshme, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura arsyeja e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është e pa bazuar.

Sa i përket arsyeve të AK-së për pozicionet e mëposhtme:

Nr.13 Tavolinë për takime-mbledhje për Katër persona - Ndërsa te përshkrimi i specilikave teknike shkruan: Dimension standard për tre persona. ku e ka cekur se kjo ka shkaktuar konfuzion edhe te Operatorët Ekonomik ku disa kanë ndërhyrë në këto specifika teknike në ofertën e tyre, po ashtu mungojnë edhe dimensionet e tavolinës.

Nr.14 Tavolinë për takime-mbledhje për Gjashtë persona - Ndërsa te përshkrimi i specifikave teknike shkruan: Dimension standard për tre persona. ku e ka cekur se kjo ka shkaktuar konfuzion edhe te Operatorët Ekonomik ku disa kanë ndërhyrë në këto specifika teknike në ofertën e tyre, po ashtu mungojnë edhe dimensionet e tavolinës.

Nr.15 Tavolinë për takime-mbledhje për Dymbëdhjetë persona - Ndërsa te përshkrimi i specifikave teknike shkruan: Dimension standard për tre persona. ku e ka cekur se kjo ka shkaktuar konfuzion edhe te Operatorët Ekonomik ku disa kanë ndërhyrë në këto specifika teknike në ofertën e tyre, po ashtu mungojnë edhe dimensionet e tavolinës

Ju sqarojmë se arsyet e AK-së për pozicionet e lartcekura janë absurde pasi që nuk mund të shkaktohet konfuzion tek operatorët ekonomik sa i përket pozicioneve të lartcekura sepse përderisa në njërin pozicion është kërkuar tavolinë për 4 persona në tjetrën për 6 persona dhe të fundit për 12 persona. shihet qartë se AK-ja e ka cekur për tre persona është vetëm një gabim i AK-së pasi që konfuzioni nuk mund të shkaktohet këtu sepse nuk mundet të kërkohet tavolina për 12 persona dhe dimensioni për tre persona andaj. duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se këtu nuk kemi të bëjmë fare me konfuzion tek OE pasi që siç e kemi cekur më lartë OE të cilët kanë ofertuar janë operatorë me përvojë ku edhe përkundët gabimeve të AK-së është dashur të ofertojnë me dimensionet standarde për tavolinat e lartcekura. pra aty ku është kërkuar lloji i tavolinës dhe numri i personave është dashur të ofertohet në bazë të dimensioneve standarde për ato tavolina, ashtu siç kemi ofertuar ne sipas dimensioneve standarde. Andaj arsyetimi i AK-së nuk qëndron për faktet të cilat u përmendën më lartë dhe shihet qartë se oferta jonë është e përgjegjshme edhe përkundër gabimeve të autoritetit kontraktues dhe është dashur

të konsiderohet edhe nga ana e AK-së e përgjegjshme, mirëpo AK-ja siç duket nuk e ka analizuar fare ofertën tonë, veprim k\ që tregon jo seriozitetin e AK-së në lidhje me ofertën tonë.

Gjithashtu sa i përket arsyeve të AK-së për pozicionin Nr. 16 Tavolinë për pritje për vizitor - ku e ka cekur se i mungon dimensioni i profilit të metalit.

Poz.\r.20 Ulëse treshe për Korridor - ku e ka cekur se i mungojnë Dimensionet.

Poz.Nr.21 Ulëse treshe për Oborre - ku e ka cekur se i mungon dimensioni i profilit të metalit dhe mungojnë Dimensionet, ju sqarojmë se arsyetimet e AK-së se mungojnë dimensionet për pozicionet e lartcekura janë të pa bazuara pasi që siç e cekëm më lartë ne kemi ofertuar sipas dimensioneve standarde në lidhje me pozicionet e lartcekura andaj arsyet e autoritetit kontraktues për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nuk qëndrojnë sepse përderisa ne kemi ofertuar sipas dimensioneve standarde të cilat pas përmirësimit të gabimeve të AK-së do të ishin të njëjtat me dimensionet me të cilat ne kemi ofertuar. prandaj është dashur që oferta jonë të pranohet si e përgjegjshme. Pra ne jemi OE i përgjegjshëm në këlë aktivitet të prokurimit dhe gjithashtu jemi OE më i lirë se të gjithë OE e tjerë ofertues

Në lidhje mc pozicionin Nr.22 Krevat pcr një person profili me trashësi të mureve 16 mm-20-mm ku AK-ja e ka cekur se nuk janë të definuar si duhet. ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar pasi që edhe përkundër gabimit të autoritetit kontraktues ne keini ofertuar me dimensionet standarde sa i përket këtij pozicioni. Andaj edhe pse AK-ja nuk i ka definuar si duhet parametrat për këtë pozicion. oferta jonë është dashur të cilësohet si c përgjegjshme dhe të rekomandohemi për kontratë. pasi që siç edhe e cekëm edhe më lartë ne kemi ofertuar ashtu siç është dashur të ofertohet pra me dimensionet standarde në lidhje me këtë pozicion

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht jemi OE më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit për pjesën 1. andaj edhe është dashur të rekomandohemi për kontratë dhe jo të anulohet aktiviteti i prokurimit për shkak të kinse konfuzioneve të OE ofertues. pasi që ne po dëmtohemi në këtë rast si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht më i lirë'

Ne me dt. 28.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së ku e ka cekur se është bërë një ankesë e pa sqaruar. ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së nuk qëndron pasi që pretendimet tona kanë qenë shumë të qarta dhe të shpjeguara në detaje andaj nuk qëndron ky arsyetim i AK-së

AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së. sepse na ka diskriminuar

neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit. të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve. kritereve dhe specifikimeve përkatëse. mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që tenderi jonë ka qenë në përputhje me aspektet përmbajtjesorë lë tenderit. mirëpo AK-ja nuk na ka rekomanduar për kontratë

Ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP). sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

AK-ja është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së. pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase. më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ë ulët

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Autoriteti kontraktues lidhur me ketë tender nuk ka bere vlerësim te ofertave me arsyetimin se specifikimet teknike janë te mangëta dhe duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 1.1 te LPP-së e ka anuluar të terë aktivitetin prokurimit.

Gabimet te cilat i ka theksuar AK në arsyen për anulim për Lot 1 janë si me poshtë:

Nr.4 -.Dollap ekskluzivë dimensioni (H=2000mmxW=800mm x L=450m) - thellësia e dollapit është specifikuar me metra e jo me milimetra, andaj kjo ka shkaktuar konfuzion edhe te Operatoret Ekonomik ku disa kanë ofruar për këtë dimension me metra e disa me milimetra.

Nr.9 - Vitrinë me dy dyer për zyre (W=800mmxL=410mm x L=2070mm) është kërkuar dimensioni i pllakës te jetë 2100x2660 mm, dhe peshë 110-120/kg — andaj pesha e vitrinës nuk është dashtë te vendoset ose nuk është bërë një parallogaritje e duhet duke pas parasysh se pesha është shumë e madhe (rendë).

Nr. 10 -Tavolinë ekskluzive për takime-mbledhje për Katër (4) karrige - (mungojnë Dimensionet)

Nr. l 1- Tavolinë ekskluzive për takime-mbledhje për Gjashtë (6) karrige - (mungojnë Dimensionet)

Nr.l2 -Tavolinë ekskluzive për takime-mbledhje për Dymbëdhjetë (12) karrige - (mungojnë *Dimensionet)*

Nr.13 - Tavolinë për takime mbledhje për Katër persona - Ndërsa te përshkrimi i specifikave teknike shkruan: Dimension standard për tre persona, andaj kjo ka shkaktuar konfuzjon edhe te Operatoret Ekonomik ku disa kanë ndërhy në këto specifika teknike në ofertën e tyre, po ashtu mungojnë edhe dimensionet e tavolinës.

Nr.14 - Tavolinë për takime mbledhje për Gjashtë persona- Ndërsa te përshkrimi i specifikave teknike shkruan: Dimension standard për tre persona, andaj kjo ka shkaktuar konfuzion edhe te Operatoret Ekonomik ku disa kanë kanë ndërhy në këto specifika teknike në ofertën e tyre, po ashtu mungojnë edhe dimensionet e tavolinës.

Nr.15 - Tavolinë për takime mbledhje për Dymbëdhjetë persona- Ndërsa te përshkrimi i specifikave teknike shkruan: Dimension standard për tre persona, andaj kjo ka shkaktuar konfuzjon edhe te Operatoret Ekonomik ku disa kanë kanë ndërhy në këto specifika teknike në ofertën e tyre, po ashtu mungojnë edhe dimensionet e tavolinës.

Nr.16 - Tavolinë për pritje për vizitor- i mungon dimensione i profilit te metalit

NR.20 - Ulëse treshe për Koridor - i mungojnë Dimensionet

Nr.21-Ulëse Treshe për Oborre- i mungon dimensioni i profilit te metalit dhe mungcjnë Dimensionet

Nr.22-Krevat për një person profili me trashësi të mureve 16mm-20-mm është-nuk janë te definuara si duhet.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(N/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Graniti "SHPK

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Ankesa e OE "Graniti" SH.P.K, me nr: 897/20, kundër vendimit të datës 20.10.2020 për anulim të tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit: ": Furnizim me inventar për zyre" me nr te prok: 214-20-4100-1-1-1, iniciuar nga AK– "Policia e Kosovës" për Lot I

OE ankues pretendon se AK ka bere shkelje të neneve 1,6,7,59,60 62 të LPP-së dhe shkelje të nenit 45 të UOPP, me arsyetimin se AK anulimin e tenderit e ka bërë në mënyrë të kundërligjshme.

Eksperti Shqyrtues e në parim i përkrah pretendimet ankimore pasi që arsyeja e anulimit tregon qarte për pa përgjegjshmërinë e Autoritetit Kontraktues qoftë në nivel të njësisë kërkuese qoftë në nivel të zyrës së prokurimit, për faktin se AK para se të hartoj dosjen e tenderit duhet të hartoj specifikimet teknike të cilat duhet të miratohen dhe aprovon në nivel të Autoritetit Kontraktues, e me pas të hartohet dosja e tenderit dhe të iniciohet procedura e prokurimit

Edhe vet OE ankues e pranon se tek shume artikuj mungojnë specifikimet teknike andaj është e drejte që OE ankues kur konsideron se dosja e tenderit respektivisht specifikimet teknik janë ta pa qarta atëherë lëshime te tilla të ngritën gjate fazës se tenderimit.

Tani jemi në një situatë te tillë ku në artikujt me nr. 4,9,10,11,15,16,20,21,dhe22 AK nuk ka specifikuar shume kërkesa të domosdoshme qe lidhen me artikujt siç janë dimensionet , pesha apo përshkrimi i artikujve , andaj si rezultat i lëshimeve të tilla te cilat mund te konsiderohen edhe jo të rastësishme anulimi i procedure se tenderimit nga ana e Eksperti Shqyrtues konsiderohet i domosdoshm për vet faktin se furnizim nuk mund të behet nëse nuk në kontratë nuk specifikohet kualiteti.

Nëse i referohemi arsyeve të anulimit shihet qarte se tek artikulli 4 thellësia e dollapit është parapa te jetë metër e jo milimetër, tek artikulli 9 është kërkuar pesha e vitrinës të jete 110 deri 120 kg, tek artikujt nr. 4,6,11,12,13,14 15,16 , mungojnë dimensionet, pastaj tek artikulli 21 mungojnë dimensionet e profilit te metalit etj. qe do te thotë se specifikimi teknik ka mangësi të shumta.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet pjesërisht e bazuar , ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-së pasi qe specifikimet teknike janë te mangëta

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues,- Policia e Kosovës
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues: "Graniti"SHPK